



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2022

Njoftimi i kontratës për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor, i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në faqen zyrtare të autoritetit kontraktor

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor :

Emri Ministria e Mbrojtjes
Adresa Rruga e Dibrës, (ish Shkolla e Bashkuar), Tiranë
Tel/Fax (04) 2226601/ (04) 2226602
Kutia Postare 2423
E-mail sekprokurime@mod.gov.al
Adresa e Internetit www.mod.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit : “Procedurë e kufizuar”, e klasifikuar në nivelin “Konfidencial” - (prokurim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë).

3. Objekti i kontratës : “Ndërtimi i perimetrit të sigurisë në Bazën Ajrore Kuçovë (ndriçimi, vendosja e kamerave të sigurisë dhe vendosja e sensorëve të zbulimit të ndërhyrjeve përgjatë rrethimit)”.

4. Numri i referencës së procedurës : Urdhri i prokurimit nr. 28, datë 29.03.2022.

5. Fondi limit : 458,143,000 (katërqind e pesëdhjetë e tetë milionë e njëqind e dyzet e tre mijë) lekë pa TVSH.

Shpenzimet për këtë procedurë do të përballohen nga fondet e vëna në dispozicion/planifikuara për Komandën e Forcës Ajrore, detajuar si më poshtë :

- *108,333,333 (njëqind e tetë milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2022, për Komandën e Forcës Ajrore;*
- *116,666,667 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2023, për Komandën e Forcës Ajrore dhe*
- *233,143,000 (dyqind e tridhjetë e tre milionë e njëqind e dyzet e tre mijë) lekë pa TVSH, të planifikuara/parashikuara në PBA e vitit 2024, për Komandën e Forcës Ajrore.*

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj 12 (dymbëdhjetë) ose ditë 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ose

duke filluar nga data e fillimit të punimeve me përfundim brenda 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditëve.

7. Kriteret e shpalljes së fituesit : Çmimi më i ulët i ofertës së kualifikuar.

8. Afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje :

Data 30/05/2022 (dd/mm/vvvv) Ora:10:00

Vendi i dorëzimit : Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve, Kati i III, zyra nr. 205/206.

Kjo procedurë prokurimi do të zhvillohet bazuar në :

- Ligjin nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- VKM nr. 542, date 29.9.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;

dhe përfshin dy faza kryesore :

Faza 1 - Parakualifikimi dhe përzgjedhja e kandidatëve :

Faza e parë (para kualifikimi) ka të bëjë me përzgjedhjen e kandidatëve, përpara dërgimit të ftesës për ofertë nga AK-ja. Para kualifikimi i ofertuesve është një proces i ndryshëm nga procedura e vlerësimit të ofertave, e cila përqendrohet në çmimin dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Procesi i para kualifikimit do të bëhet duke u përqendruar në vlerësimin e përvojës dhe aftësinë e kandidatëve për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Qëllimi kryesor i para kualifikimit është përzgjedhja e atyre kontraktorëve, kualifikimet dhe përvoja e të cilëve minimizon rrezikun e mosekzekutimit, sipas projektit/kontratës së propozuar.

Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në Fazën e Parë, janë përkatësisht si më poshtë :

- 1. Operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me Certifikatën e Sigurimit Industrial (CSI), lëshuar nga DSIK, e cila duhet të jetë :**
 - Jo më e ulët se niveli i klasifikimit “Konfidencial”;
 - E vlefshme në momentin e prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së klasifikuar;
 - Në përputhje me objektin specifik të prokurimit të klasifikuar.

Për këtë, ofertuesit duhet të paraqesin Certifikatë të Sigurimit Industrial, të lëshuar nga DSIK, në emër të ofertuesit.

- 2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas Shtojcës 13, të dokumenteve të tenderit të publikuara nga APP, në seksionin Legjislacioni/Prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, rubrika DST “Procedurë_e_Kufizuar_Punë”, në përputhje me parashikimet e nenit 38/1, të LPFMS.**
- 3. Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se kanë paguar të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që**

është i regjistruar në Shqipëri. Ky vetëdeklarim kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë që brenda së njëjtës periudhë nuk janë kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “*periudhë*”, nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.
5. Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës, bazuar në formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- N.P-1 A Punime gërmimi në tokë.
- N.P-2 F Ndërtime civile e industriale.
- N.P-11 C Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.
- N.P-12 A Punime të inxhinierisë mjedisore.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- N.S-8 B Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri.
- N.S-13 C Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

6. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuar nga administrata tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2019 - 2020 - 2021). Xhiro mesatare e tre viteve të fundit, nuk duhet të jetë më e ulët se 50 % e vlerës së fondit limit objekt prokurimi.
7. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të viteve financiare 2019 dhe 2020, të paraqitura në organet tatimore dhe të çertifikuara/konfirmuara nga ana e këtyre organeve dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 10091 datë 5.3.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar*”, i ndryshuar.

8. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2021.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar aktivitet për periudhën e vitit 2021, sipas të dhënave të QKB-së.

9. Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :
- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit;
 - b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorëve Ekonomikë do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme :

- Për kontrata të realizuara me institucione shtetërore :
 - kontratë;
 - formular vlerësimi;
 - situacionet pjesore si dhe faturat tatimore për çdo situacion punimesh (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë);
 - situacion përfundimtar;
 - akt kolaudimi.
 - Për kontrata të realizuara me subjekte private :
 - kontrata përkatëse;
 - situacionet pjesore si dhe faturat tatimore për çdo situacion punimesh (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë);
 - situacioni përfundimtar;
 - akt kolaudimi.
- **Per kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :** Kontratën e bashkimit të operatorëve dhe prokurën e posaçme të deklaruara në fazën e tenderimit.
- **Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë :** Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

10. Operatorët ekonomikë duhet të kenë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontrates, i cili duhet të jetë pjesë e përvojës së operatorëve ekonomikë në fushën objekt prokurimi.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se për periudhën Janar - Mars 2022 kanë patur në dispozicion punonjësit si më poshtë :

- Numri mesatar për muaj i punonjësve për periudhën në fjalë nuk duhet të jetë më i ulët se 90 (nëntëdhjetë) punonjës (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues).

Kjo të dëshmohet me Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën e sipërpermendur dhe të shoqërohet me list-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a.

11. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Elektronik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- kontratë pune të vlefshme dhe
- diplomën universitare.

12. Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjës Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

13. Në funksion të hartimit të ofertës dhe në kushtet kur ky proces kërkon akses tek informacioni i klasifikuar që administrohet nga Autoriteti Kontraktor, operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë personelin që plotëson kushtet e përcaktuara për njohjen, ruajtjen, administrimin dhe transferimin e informacionit të klasifikuar.

Për këtë, ofertuesit duhet të paraqesin :

- Dokumente/vërtetime të lëshuara nga DSIK ose CSI të lëshuar në emër të ofertuesit, ku të evidentohet personeli i pajisur me CSP si më poshtë :
- Administratori i shoqërisë
- Inxhinieri Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik/Elektronik 1 (një)
- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

Punonjësit si më sipër, janë kërkuar në funksion të përgatitjes së ofertës dhe zbatimit të kontratës pasi do të kenë akses në informacionin e klasifikuar lidhur me projektet e zbatimit, preventivat e punimeve, skica, planimetri, të dhëna dhe specifikime teknike, etj.

Në rast se gjatë zbatimit të kontratës, OE fitues do ti lindë nevoja për angazhimin e punonjësve të tjerë, ka detyrimin që aksesin në informacionin e klasifikuar të bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara në VKM nr. 542, datë 29.09.2021 “Për rregullat, procedurat dhe kërkesat për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

14. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licencë lëshuar nga QKL “Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte dhe dherave”, kodin III.2.B (Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte dhe dherave”), së bashku me aktin e miratimit.

15. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe sigurisë së informacionit. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme :

- a) Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- b) Çertifikatë **OHSAS 18001-2007** mbi “Shëndetin dhe Sigurimin në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim dhe/ose certifikatën ekuivalente të njohur nga standardet shqiptare **ISO 45001-2018**;
- c) Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
- d) Certifikatë **ISO 27001:2013** mbi “Menaxhimin e sigurisë së informacionit” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Operatorët ekonomikë për tu kualifikuar në fazën e parë të procedurës, duhet të dorëzojnë dokumentacionin në përputhje me kërkesat e përcaktuara si më sipër, në një zarf të mbyllur, jo transparent, të nënshkruar dhe vulosur nga ana e tyre. Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës.

Formulari i kërkesës për pjesëmarrje duhet të plotësohet sipas formatit të dokumenteve të tenderit të publikuara nga APP në seksionin Legjislacioni/Prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, rubrika DST “Procedurë e Kufizuar Punë”.

Faza 2 - Ftesa për Ofertë dhe vlerësimi : Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët të cilët kanë plotësuar kërkesat për para-kualifikim duke i ftuar të njihen me dokumentet e tenderit dhe në vijim të përgatisin dhe të dorëzojnë ofertat sipas përcaktimeve në DT dhe të specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën, fituese.

NJËSIA E PROKURIMIT